



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 720, datë 14.5.2008

P Ë R

**MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS
“BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “SIGERS”,
SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “MARTANESH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Sigers”, shpk, për ndërtimin e hidrocentralit “Martanesh”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERËJETIKËS**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 1092 Rep.
NR. 187 Kol.



KONTRATE KONCESIONI

E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM) PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT "MARTANESH"

Ne Tirane, me date 09 muaji Maj, viti 2008 (dy mije e tete), u paraqiten para meje notere te regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese _____, palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, qe me poshte do te quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", percaktuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.551, date 29.08.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentralit "Martanesh", perfaqesuar me autorizimin nr.3164/21, date 12.03.2008, nga z. Kristo RODI, i biri _____ i datelindjes _____ madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi NF

DHE

Shoqerise "Sigers" shpk, me seli ne Tirane, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.7449, dt.02.12.1994, te Gjykates se Rrethit Tirane; regjistruar ne organin tatimor me nr. Nipt J 91802011 A, qe me poshte do te quhet "Koncesionari", perfaqesuar nga administratori Z. Muharrem Pllloçi, i biri _____, i datelindjes _____ banues ne nr. _____ nr. _____, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta me nr. _____ madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Hyrje

Duke patur parasysh qe:

Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;
2. Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise.

3. Vlereson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur stimulimin e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;
5. Mirepret investitoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike.

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit "Martanesh", si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentralit "Martanesh", komuna Martanesh, Rrethi Bulqize, me qellimin prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
3. Shoqeria "Sigers" sh.p.k. zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;
4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 551, date. 29.08.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentralit "Martanesh", dhe bien dakort për sa më poshtë:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1


Perkufizime dhe interpretime

Kudo qe ne kete Marreveshje perdoren termat e meposhteme, ato do te kene kuptimet perkatese si me poshte si vijon :

1. **Kontrata e Koncesionit** : Kjo kontratë, aneksi/aneokset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
2. **Ligji "Për Koncesionet"**: Ligji nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet".
3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.
4. **Koncesionari**: Shoqeria "Sigers" Sh.p.k, me seli ne qytetin e Tiranes, e cila do te realizoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo kontrate nepermjet shoqerise qe do te themeloje ajo me qellim per te realizuar kete koncension.
5. **Hidrocentral**: Hidrocentrali "Martanesh", me vendndodhje ne komunen Martanesh, Rrethi Buqize, me fuqi të instaluar 8.800 kW dhe prodhim të energjisë

prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalit e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluara në të.

6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit "Martanesh" dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
7. **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të Hec-it, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
8. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit "Martanesh",
9. **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.
10. **Vënia në punë e hidrocentralit:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
11. **Kontratrat:** Te gjitha kontratat e nenshtruara nga Koncesionari, me sipërmarresit për realizimin e punimeve;
12. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektivit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin shqiptar.
13. **Tarifa koncesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
14. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
15. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.
16. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari.
17. **"Dokumentet e Financimit"** nënkuptojnë çdo marrëveshje huaje, njoftime, obligacione, marrëveshje me shkrim, marrëveshje garancie, deklarata regjistrimi ose zbulimi, marrëveshje varësie, hipoteke, vepra besimi, marrëveshje kredie, marrëveshje blerjeje policash ose obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera të regjistruara nga Kompania e Projektit në lidhje me financimin e projektimit, prokurimit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Kompleksit dhe për ushtrimin e të Drejtave të Koncesionit, duke përfshirë çdo modifikim, plotësim, zgjerim, rinovim dhe zëvendësim të ndonjë financimi të tillë.
18. **"Pala Financuese"** nënkupton çdo person ose persona që japin financim borxhi ose rifinancim sipas Dokumenteve Financiare të Kompanisë së Projektit për projektimin, prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Kompleksit dhe për ushtrimin e të Drejtave të Koncesionit, si dhe pasardhësve dhe përfituesve të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues të besuar për atë person



ose persona, por jo duke përfshirë një Aksioner ose filial të një Aksioneri në lidhje me mbetjen borxh që përfshin Entin.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Objekti i kesaj kontrate koncesioni eshte :

Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për koncesionet", i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT:

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit Martanesh dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentralit "Martanesh"

Hidrocentrali "Martanesh" do të ndërtohet në rrjedhën e sipërme të lumit Radiçinë, duke shfrytëzuar 3 deget e tij, Licone, Theker e Lene, në Rrethin Bulqize, me këto karakteristika:

- Kuotat e veprave:
 - o Kuota e vepres se marrjes 1 840 m
 - o Kuota e vepres se marrjes 2 838 m
 - o Kuota e vepres se marrjes 3 1160 m
- Kuota e godines se centralit 713 m
- Prurja llogaritëse 5.2 m³/sek
- Fuqia e Instaluar 8.800 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike 45.555.821 kWh/vit

Neni 4

Kohëzgjatja e Kontratës së Koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion ndërtimin e hidrocentralit "Martanesh" për një periudhë 35 (tridhjetepese) vjeçare.

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se, nga ana e Koncesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate.

KREU II
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5
Pronësia dhe dorëzimi i asetëve të projektit

1. Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore që do t'i shërbejnë objektit të kontratës së koncesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues.

Neni 6
Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në çdo kohë, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

2. Mbikqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë një mbikqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme. Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7
Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.
2. Të ndihmojë Koncesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme për marrjen e licencave ose lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kësaj kontrate.
3. Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vete Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në

proceduren e gares. Koha e nevojshme per miratimin e projektit nuk ben pjese ne grafikun e punimeve te parashikuara ne Aneksin nr.2 bashkelidhur.

4. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
5. Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti i furnizimit të energjisë elektrike, për 15 vitet e para të prodhimit të energjise elektrike.
6. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e hidrocentralit "Martanesh".

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

1. Të themelojë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.
2. Të paraqese prane Autoritetit Kontraktues, per miratim projektin e zbatimit, brenda 6 (gjashte) muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te kesaj kontrate.
3. Të marre te gjitha lejet dhe licensat e nevojshme per realizimin e kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur kontratës;
5. Të marrë masa me qëllim që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e Hec-it "Martanesh" me fuqi të vendosur jo më pak se 8.800 kW;
7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
8. Të shesë të gjithë prodhimin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të paktën për 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e para te prodhimit.
9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta;
10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në

punë, të higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;

12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar;

13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9

Vleresimi i Investimeve

Mbi bazen e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 857.861.985 leke (Teteqindpesedhjeteeshtatemilion e teteqindegjashtedhjeteezemije e nenteqindetetedhjetepese) lekesh, nga të cilat 433.901.600 (katerqindetridhjeteezemilion e nenteqindeteezemije e gjashteqind) leke do të investohen në makineri e pajisje.

Vleresimi i mesipër mund të pesoje ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet paleve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit
- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave
- Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 857.861.985 (Teteqindpesedhjeteeshtatemilion e teteqindegjashtedhjeteezemije e nenteqindetetedhjetepese) leke, por jo më e vogël se 814.968.886 (teteqindekatermbedhjetemilion e nenteqindegjashtedhjeteezemije e teteqindetetedhjeteezemije e gjashteqind) leke, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5 % të investimit total të parashikuar.

Neni 10

Programi punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e miratimit të lejes së ndërtimit.
2. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur.
3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proceduriale për marrjen e tyre.
4. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonësive të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11

Testimi i veprës

Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i paisjeve, për të siguruar funksionalitetin e hidrocentralit.

Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit.

Neni 12

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

- Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidh Kontratën e Koncesionit në mënyrë të njëanshme, pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër:

1. Kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;
2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % (dhjete) të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;
3. Kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.
4. Kur Koncesionari nuk jep përgjigje të argumentuar për shkeljen, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor të parashikuar në nenin 24 të kësaj kontrate.

Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës.

2. Zgjidhja e kontratës nga secila palë.

- Secila palë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër, kur:

1. përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;
2. ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar me marrëveshje mes tyre.

3. Zgjidhja e kontratës me konsensus

- Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës nga secila palë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e HEC-it, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentralit te Autoriteti Kontraktues.

4. Të Drejtat e Palëve Financuese

1. Njoftimi mbi Shkeljen e Kontrates

Menjëherë pas marrjes dijeni për një Shkelje të Kontrates nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues njofton për këtë Palët Financuese me qëllim të dhënies së mundësive Palëve Financuese për të korigjuar ose marrë masa për të rregulluar këtë Shkelje të Kontrates nga Koncesionari brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë dhe Autoriteti Kontraktues u jep Palëve Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se një Shkelje Kontrate nga Koncesionari nuk korigjohet prej Koncesionarit brenda kohës së zbatueshme sipas Seksionit 12.1.4 ose nuk korigjohet ndryshe sipas Seksionit 12.4.1 të mësipërm, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i bëjë Koncesionarit Njoftimin e Prishjes së Kontratës.

Pavarësisht nga sa më sipër, Njoftimi për Prishjen e Kontratës do të konsiderohet i tërhequr nëse, para hyrjes së saj në fuqi, Palët Financuese zgjedhin, në pajtim me ligjin:

- (i) të realizojnë një të Drejtë Pengu mbi aksionet; dhe/ose
- (ii) propozojnë t'ia transferojnë Projektin një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues për qëllimin e vazhdimit të Projektit.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues:

- (i) nuk pengon apo vonon në mënyrë të paarsyeshme pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar menaxherial ose subjekti ka ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit, dhe
- (ii) bën ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese;

me kusht që, në pajtim me ligjin "Per koncesionet", ky zëvendësim të jetë i kufizuar në një periudhë prej (12) dymbëdhjetë muajsh të njëpasnjëshëm, dhe në çdo kohë gjatë kësaj periudhe Autoriteti Kontraktues organizon një proces të ri tenderimi për Projektin, siç parashikohet më poshtë.

3. Procesi i Tenderimit

Nëse Autoriteti Kontraktues organizon një proces tenderimi për Projektin në pajtim me ligjin siç parashikohet në Seksionin 12.4.2 më sipër, ai do të kerkojë mendimet dhe përfshin në mënyrë të arsyeshme Palët Financuese (me kërkesë të tyre) në përgatitjen dhe zbatimin e procesit të tenderimit (duke përfshirë përgatitjen, negocijimin dhe finalizimin e marrëveshjes së ndryshuar të koncesionit me një koncesionar palë të tretë) me qëllim sigurimin e vazhdimit të Projektit duke marrë parasysh interesat e Autoritetit Kontraktues dhe Palëve Financuese.

4. Bërja e Pagesave për Prishjen e Kontratës

Nëse, pavarësisht Seksioneve 12.4.1 deri 12.4.3 më sipër, Palët Financuese zgjedhin për të mos ushtruar të drejtat e parashikuara atje, ose pavarësisht ushtrimit të këtyre të drejtave nuk shihet asnjë opsion i arsyeshëm vazhdimi dhe Projekti duhet të ndërpritet.

Autoriteti Kontraktues mund ta prishë këtë Marrëveshje dhe, me kërkesën e parë të Palëve Financuese, bën pagesat e prishjes së kontratës në mënyrën e treguar atje.

Neni 13 Kontratat

Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit.

Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.

Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 14 Sigurimi i kontratës

Konçensionari duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, para firmosjes së kontratës, një shumë prej 85,786,198 (tetedhjeteepesemilion e shtateqindetetedhjeteeqjashtemije e njeqindenedhjeteeetete) lekë, qe perben 10 % të vlerës totale të investimit.

Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkelidhet kësaj kontrate.

Konçensionarit i lejohet të ç'ngurtësoje këtë vlerë vetëm pasi të ketë kryer investimin e plotë dhe të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga realizimi i investimit, kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë e saj.

Neni 15 Sigurimet

Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë fazës së shfrytëzimit, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 te Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë shfrytëzimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguroresi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për

të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.

Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 (dyqindmije) Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 (peseqindmije) Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jete më e lartë se 1000 (njemije) Euro për çdo ngjarje dhe 2000 (dymije) Euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

1. Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguaje për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 5 % të energjisë elektrike të prodhuar në një vit.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit.

2. Vlera e riinvestimit

Çdo 15 (pesebëdhjete) vjet Koncesionari do të riinvestojë 73.37 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet.

Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 17

Kufizimet

Koncesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë.

Për çdo transferim të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet në pronësi të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër pa miratim të Autoritetit Kontraktues mbi asetet që do të ndërtohen apo blihen prej tij gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neni 18

Raportimi

Koncesionari është i detyruar që çdo tre muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas

sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19 **Legjislacioni i zbatueshem**

Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Koncesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar.

Neni 20 **Forca Madhore**

Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore, katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve .

Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose pezullimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Në rast se kontrata do të zgjidhet për shkak të forcës madhore asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi ndaj palës tjetër për kostot apo dëmet që rrjedhin nga mospërmbushja e Kontratës.

Neni 21 **Hyrja ne fuqi e Kontrates se Koncesionit**

Kontrata e Koncesionit do te hyje ne fuqi mbasi te jete miratuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Ligjin Nr.9663, date 18.12.2006 "Per koncensionet".

Neni 22 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit.

Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore/të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 23 Sanksionet

1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës 15 mujore të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Konçesionarin si më poshtë:
 - a. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
 - b. Për moskryerje ne total të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurim. Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të perealizuara
 - c. Për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 (dhjetemije) lekë.
2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakort me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
 - a. Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 45.555.821 KWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese.
 - b. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Koncesionari do të penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.
3. Mosparaqitja ne kohe e projektit te zbatimit per miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar ne nenin 8, pika 2 te kesaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005% te vleres se investimit.

Sanksionet paguhen ne llogari te Autoritetit Kontraktues.

Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 10 (dhjete) ditësh.

Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

Neni 24

Rregullimi i shkeljeve

Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse.

Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 25

Transferimi i Aseteve

Me mbarimin e Kontratës së Koncesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e Koncesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e Koncesionit, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.

Transferimi do të përfshijë, por pa u kufizuar në to:

- Dorëzimin fizik të asetëve.
- Dorëzimin e dokumentave që shoqërojnë këto asetë.
- Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me këto asetë.
- Kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Koncesionari.

Koncesionari duhet të garantojë se këto asetë janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.

Neni 26

Mbarimi i kontratës

Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35(tridhjetëpese) vjeçar.

Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27

Konfidencialiteti

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28

Ndryshime

Kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të dy palëve.

Çdo amendim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29

Bashkepunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari jane zotuar te bashkepunojne ne menyre qe te garantojne realizimin e plote te projektit.

Çdo komunikim per çdo problem ndermjet paleve, do te behet me shkrim, ne adresat e treguara me poshte nga palet. Palet jane te detyruara t'i njoftojne menjehere njera-tjetres çdo ndryshim te cilesdo prej ketyre koordinatave.

Per cdo ndihme qe do t'i kerkohet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet te paraqese kerkesen me shkrim per çka kerkon ne zbatim te detyrimeve te kesaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e fakseve zyrtare qe do te perdoren gjate zbatimit te kesaj Marreveshje jane:

Per Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes
Blvd. Zogu i Pare, Nr. 1001,

Tirane – Shqiperi

Per Koncesionarin

Shoqeria "SIGERS" sh.p.k.

Rruga "Mustafa Lleshi

Vila nr.1

Tirane – Shqiperi

Tel./Fax

Cel. +35

mail: sigersconstruction@yahoo.com

Neni 30

Rregjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të rregjistrohet në rregjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe
Energjetikes

Perfaqesuar me Autorizimin Nr. 3164/21 Prot.,
date 12.03.2008 te Ministrit te Ekonomise,

Tregtise dhe Energjetikes

Nga Z. Kristo Rodi

KONCESIONARI

Shoqeria "Sigers" Shpk

Perfaqesuar nga

Administratori

Z. Muharrem Pllaçi